

Thirrje publike për shprehje interesi

Banka Qendrore e Kosovës (BQK), është duke shqyrtuar mundësinë e marrjes në përdorim (me qira) të një objekti shtesë për të adresuar nevojat aktuale dhe rritjen e planifikuar, prandaj publikon thirrje publike për shprehje interesi nga palët e interesuara për ofrimin e një hapësire administrative (objekt) të përshtatshëm për përdorim administrativ. Kjo thirrje ka për qëllim të identifikojë hapësirat ekzistuese që përmbushin kërkesat ligjore, teknike dhe funksionale për vendosjen e stafit dhe zhvillimin e operacioneve institucionale.

Kjo thirrje nuk përbën asnjë obligim për BQK-në, ndërsa institucioni rezervon të drejtën të modifikojë, pezullojë ose anulojë këtë thirrje në çdo fazë, sipas vlerësimit të saj të brendshëm.

1. Qëllimi dhe kohëzgjatja e qirasë

- 1.1. Qëllimi i shpalljes: Sigurimi i informacionit për objekt për zyra që përmbush kushtet ligjore, teknike dhe funksionale.
- 1.2. Kohëzgjatja: Shfrytëzimi i objektit parashihet për një periudhë minimale prej 5 (pesë) vitesh, me mundësi vazhdimi.

2. Kriteret ligjore

- 2.1. Ofertuesi duhet të jetë pronar i ligjshëm i objektit, ose të ketë të drejtën ligjore për ta ofruar objektin me qira;
- 2.2. Për objektin, nuk duhet të ketë konteste gjyqësore, ngarkesa hipotekare apo çështje tjera të pazgjidhura pronësore.
- 2.3. Objekti duhet të ketë: leje ndërtimi dhe pranim teknik;
- 2.4. Pronari i objektit të mos jetë në ndjekje penale/ i dënuar për vepër penale;

3. Kriteret funksionale

- 3.1. Lokacioni i objektit duhet të jetë në rreze jo më larg se 1000 metra nga selia e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës;
- 3.2. Sipërfaqja duhet të jetë me hapësirë neto rreth 1,000 m², e përdorshme për zyra (me tolerancë ±15%).
- 3.3. Të ketë qasje të lehtë në transportin publik;
- 3.4. Hapësirat e brendshme të jenë të përshtatshme ose të mund të përshtaten për zyra, salla takimesh, arkiva, zona teknike etj.
- 3.5. Fleksibilitet për përshtatje/ndarje të hapësirave pa ndërhyrje strukturore;
- 3.6. Të ketë hapësira të mjaftueshme për parkim, së paku 3 vende parkimi (staf, vizitorë, në objekt ose shumë afër);
- 3.7. Të ketë qasje të përshtatshme për persona me aftësi të kufizuara;

4. Kriteret teknike dhe të sigurisë

- 4.1. Të ketë instalime të ligjshme dhe funksionale të energjisë elektrike, ujësjellësit dhe kanalizimit;

- 4.2. Minimum dy (2) nyje sanitare të veçanta në çdo kat;
- 4.3. Ndriçim, ajrosje natyrale adekuate dhe ventilim të përshtatshëm;
- 4.4. Dalje emergjente funksionale;
- 4.5. Sistem i integruar i ngrohjes dhe ftohjes (preferohet sistem qendror);
- 4.6. Ashensor funksional (nëse objekti ka më shumë se dy kate);
- 4.7. Mundësi për instalimin e sistemeve të sigurisë (kamera, alarm, kontrolle të qasjes, rrjet të kompjuterëve);
- 4.8. Mundësi për instalimin e sistemit të alarmit dhe mbrojtjes nga zjarri;
- 4.9. Mundësi për instalimin e lidhjeve të internetit;
- 4.10. Hapësirë e veçantë për ndërlidhjen e rrjetit. Kjo hapësirë duhet të ketë furnizim me energji elektrike dhe mundësi për vendosjen e pajisjeve ftohëse (klimave montuese).
- 4.11. Mjedis pa lagështi;

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen nga ofertuesit

- 5.1. Certifikata e pronësisë ose dokument tjetër që dëshmon të drejtën për ofrimin e objektit me qira;
- 5.2. Dokument identifikimi i pronarit të objektit;
- 5.3. Leja e ndërtimit dhe pranim teknik;
- 5.4. Plani i objektit dhe specifikimi i sipërfaqeve neto të brendshme;
- 5.5. Fotografitë e objektit (fasada, ambientet e brendshme, hapësirat e parkimit) dhe përshkrimi i instalimeve;
- 5.6. Të dhëna mbi çmimin e propozuar për qira mujore për metër katror (me TVSH);
- 5.7. Të dhëna mbi periudhën e disponueshmërisë dhe statusin aktual të objektit;
- 5.8. Referenca të qiradhënësit (objekte të menaxhuara/qiradhënie të mëhershme), nëse ka.

6. Afatet dhe mënyra e dorëzimit

- 6.1. Afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve është **10 tetor 2025, ora 14:00**.
- 6.2. Dokumentacioni mund të dorëzohet:

- fizikisht në adresën e BQK-së, zyra e Arkivit: Rr. "Garibaldi" 33, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës;

7. Kontakti për informata sqaruese

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, BQK

Ueb.: www.bqk-kos.org

E-mail: prokurimi@bqk-kos.org

Te.: +383 38 222 055 425

BQK rezervon të drejtën të kërkojë dokumente plotësuese, të realizojë vizita në objektet e propozuara dhe të mos përzgjedhë asnjë ofertë nëse asnjëra nuk përmbush nevojat institucionale.

BQK nuk pranon dhe nuk mban përgjegjësi apo rimbursos asnjë kosto të shkaktuar për të marrë pjesë në këtë ftesë publike.

Kjo thirrje shërben për nevoja të BQK-së dhe nuk përbën të drejta apo detyrime ndaj asnjë pale.